



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-5017/17, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës merr:

VENDIM

PËR ZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NË PROJEKTIN “PËRKRAHJE TË FERMERËVE PËR UJITJEN E SIPËRFAQEVE BUJQËSORE TË MBJELLURA ME MJEDËR, BORONICË, ARONI, MOLLË, SPEC DHE KARROTA” NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Zgjedhën 258 (Dyqind e pesëdhjet e tetë) përfitues në projektin “Përkrahja e fermerëve për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore (Sistemi i ujitjes pikë – pike”) nga 0.50 ha, të mbjellura me mjedër, boronicë, aroni, mollë, spec, karrota, projekt në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 2

Lista e përfituesve është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3


Përkrahja në kulturat e cekura bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit bujqësor në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Nr.02-320/01-0030381/17

**Podujevë,
18 prill 2017**



**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**